V E N D I M
Nr.592, datë 28.8.2003

PËR DHËNIEN ME KONCESION TË UZINËS SË TELAVE E KABLLOVE SHKODËR DHE PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË OFERTAVE PËR MARRJEN ME KONCESION TË KËTIJ OBJEKTI

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 dhe 7 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurave për dhënien me koncesion të uzinës së telave e kabllove në Shkodër.
2. Koncesioni të jetë i formës "ROT" (rehabilitim-operim-transferim).
3. Organi shtetëror i autorizuar për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të jenë Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.
4. Organi shtetëror të ngrejë grupin e punës, i cili të shqyrtojë ofertat e paraqitura, sipas kritereve të mëposhtme të vlerësimit:
- Vlera e investimit40 pikë
- Punësimi15 pikë
- Koha e vënies në punë15 pikë
- Përvoja në këtë lloj veprimtarie
ose në një veprimtari të ngjashme
me të20 pikë
-Planbiznesi (për anën financiare)10 pikë.
5. Procedurat e shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave të përfundojnë brenda 45 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano